

Bardhyl Hoxha, MA¹

UDC:
327:911.3(497-15)

**GJEOPOLITIKA DHE SIGURIA BASHKËPUNUESE NË
BALLKANIN PERËNDIMOR**

**ГЕОПОЛИТИКАТА И БЕЗБЕДНОСНАТА СОРАБОТКА ВО
ЗАПАДЕН БАЛКАН**

**GEOPOLITICS AND COOPERATIVE SECURITY IN WESTERN
BALKANS**

Abstract

In the new geopolitical reality and the security environment created in the Balkans, almost all countries in the region have taken positive steps to create collective stability, defining common security threats and threats at regional level. The EU's and NATO's intense

¹ Pas përfundimit të studimeve në Akademitë Ushtarake në Tiranë dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Tiranës, si dhe pas disa specializimeve në SHBA, Gjermani dhe Malajzi, Gjeneral Brigade (R) Hoxha ka kryer shumë detyra, ku më të rëndësishmet janë: Pedagog dhe Zv.Dekan në Akademinë Ushtarake "Skënderbej"; Zv.Shef Shtabi i Brigadës së Evropës Juglindore në Bullgari; Ndihmës Shef Shtabi për Komunikimin në Shtabin e Forcave të NATO-s në Kosovë; Drejtor Logjistike dhe Drejtor i Buxhetit të Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes; Komandant i Brigadës Logjistike dhe Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes; Ndihmës i Shefit të Shtabit për Marrëdhëniet Civile-Ushtarake në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Evropë në Belgjikë; Aktualisht merret me kërkime për siguri dhe mbrojtje dhe është Lektor në Kursin e Lartë Ndërkombëtar për Siguri dhe Mbrojtje në Akademinë e Forcave të Armatosura. Autor dhe bashkautor i disa teksteve mësimore, studimeve dhe shkrimeve të botuara në revistat shkencore, si dhe disa direktivave, doktrinave dhe manualeve, në fushën logjistike dhe të sigurisë, që aktualisht janë në përdorim të Forcave të Armatosura .(hoxhaba1@gmail.com)

engagement in the Balkans remains a necessary factor and clearly expresses the desire of the Balkan countries to integrate into Euro-Atlantic structures. The goal of the NATO and EU Presence in the region is to play a key role, particularly in implementing reforms in strengthening the legal framework, the security sector, as well as the fight against terrorism and the crime organization.

Historically, in a historical and geostrategic view, the Balkan region has played an important and extraordinarily important role in European developments (Ribaj, "Sfidat e rajonit të Ballkanit", Tiranë, 2005, f. 75., 2005).

The geopolitical configuration of the Balkans is still unfinished as several issues remain in the region that can restrain it to the whirlwind of violence (Puto, "Ballkani koha për të ndryshuar", 1996). The factors that influenced the new geopolitical configuration were the collapse of the communist system and the end of the Cold War, which created the premises for the building of an undivided, large and free, stable and peaceful, democratic and prosperous Europe.

This new geopolitical reality brought about the creation of new states with ethnic and religious problems, with its own distinguishing features, which have been in the attention of the international public.

A healthy partnership involves establishing cooperative relationships and trust, as well as engaging each country in achieving jointly-agreed goals: empowering peace, democracy, respect for human rights, economic prosperity, reconciliation and stability across the region.

Key words: Geopolitics, the Western Balkans, cooperative security, integration, regional initiatives, NATO, EU.

Hyrje

Konfliktet ballkanike të fundshekullit XX, kërcënuan përsëri realitetin dhe balancën e brishtë të periudhës së pas rënies të komunizmit. Shpërbërja e dhunshme e ish-Jugosllavisë ka ndikuar shumë në krijimin e realitetit të ri gjeopolitik, i cili çoi në rënien e blloqeve ideologjike në rajon, e shoqëruar me zvogëlimin gjithnjë e më shumë të konflikteve të mundshme të Fuqive të Mëdha.

Shpërbërja e ish-Jugosllavisë u shoqërua me tensione ndëretnike të përgjakshme që çuan në disa luftëra, përfshirë këtu edhe ndërhyrjen e parë të NATO-s, duke konsumuar jo vetëm vlera materiale e moneta, por edhe mjaft iniciativa të lodhshme diplomatike rajonale e

evropiane.² Me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe shpërbërjen e dhunshme të ish-Jugosllavisë, Ballkani paraqitet me një realitet të ri gjeopolitik. Përveç shteteve kryesore klasike u krijuan shtete të tjera, të cilat kanë karakteristikat e veta dalluese.

Sipas Oleg Levitin dhe Peter Sanfey, në shkrimin e tyre të muajit shkurt 2018 “Bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor”,³ bashkëpunimi rajonal ka qenë një nga arritjet më të mëdha të Ballkanit Perëndimor dhe ka sjellë me vete dy përfitime kryesore. Së pari, zvogëlon tensionin dhe forcon stabilitetin rajonal. Dhe, së dyti, sjell përfitime të ndryshme praktike që rrjedhin nga nivelet më të larta të flukseve brenda-rajonale të mallrave dhe shërbimeve, konkurrencën e përmirësuar të ekonomive relativisht të vogla dhe rritjen e atraktivitetit të rajonit si një destinacion investimi.

Bashkimi Evropian mbetet spiranca kryesore e jashtme për stabilitetin e rajonit dhe reformat gjithëpërfshirëse. Forcimi i bashkëpunimit rajonal është një kërkesë e qartë për vendet aspiruese të vendeve të Ballkanit Perëndimor në ofertat e anëtarësimit në BE. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi rajonal sot është një zgjedhje e mirinformuar nga ana e udhëheqësve rajonal. Krahasuar me pengesat e mbetura për integrimin rajonal, si infrastruktura dhe mjedisi i pabarabartë i biznesit, pengesat e pastra politike janë shumë më pak të rëndësishme.

Intensiteti dhe diversiteti i bashkëpunimit rajonal, dimensionet e të cilave janë zgjeruar me dhjetëra institucione dhe nisma, është një kontribut real për stabilitetin rajonal. Megjithatë, kushtet ekonomike mbeten të vështira, pavarësisht rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit, papunësia dhe varfëria janë të përhapura dhe pavarësisht prirjes afatshkurtër të rritjes, ajo është e pamjaftueshme për të ngushtuar ndjeshëm hendekun në standardet e jetesës me BE. Në kuadrin e Zonës së re Ekonomike Rajonale, përqendrimi duhet të jetë në përpjekjet shtesë në disa fusha të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë ekonomik të rajonit, si: heqja e barrierave tregtare, rritja e bashkëpunimit dhe mundësive për investime, rritja e lëvizshmërisë rajonale dhe zhvillimi i integritetit digjital.

² <http://www.esiweb.org/GeopoliticsattheEndoftheTwentiethCenturyTheChangingWorldPoliticalMap>.

³ Oleg Levitin and Peter Sanfey “Regional cooperation in the Western Balkans”, hyrë më 27 April 2018 file:///C:/Users/PC/Downloads/western-balkans-summit-paper.pdf, hyrë më 10 Maj 2018.

Vështrim historiko-gjeografik për Ballkanin

Në Ballkan bashkëjetojnë shtrënguar 12 shtete që, siç thotë poeti shqiptar Xhevahir Spahiu: “*supi i njërit nën sjetull të tjetrit*”.⁴ “*Emri i rajonit, Gadishulli Ballkanik (Ballkan Halbinsel), është emër i sajuar në fillim të shek. XIX nga gjeografi gjerman August Zeune*”, në përpjekje për të shmangur emra që në atë kohë ishin politikisht të gabuar, të tillë si: “*pjesa evropiane e Turqisë*” ose “*Turqia në Evropë*”.

Rajoni i Ballkanit ka qenë i shndërruar në një fushëbetejë për “interesa të Fuqive të Mëdha në periudha të ndryshme, por shpesh edhe i konflikteve e luftërave civile”.⁵ Historia e tij është e dominuar nga luftërat, rebelimet, pushtimet dhe nga përplasjet midis perandorive, që nga koha e Perandorisë Romake deri te luftërat e vona në Jugosllavi. Referuar studiuesve të ndryshëm dhe dëshmimeve gjuhësore-historike, rajoni e merr emrin e tij nga mali *Ballkan* në Bullgari, një fjalë turke, që do të thotë *mal*. Ballkani është diçka më tepër sesa zgjatja gadishullore e Evropës së zgjeruar. Ai është një zgjatim i dallueshëm fizik dhe kulturor, i cili zotëron atë që Maria Todorova e quan “*çimentim historik dhe gjeografik*”.⁶

Kuptimi i termit Ballkan në skenën gjeopolitike. Nga një vështrim i termit Ballkan, si dhe gjithë historisë së tij shekullore, mund të themi se, përgjithësisht, ky term tregon një lidhje me dhunën, konflikte fetare, përplasje etnike, si dhe kuptimin e një zone të thellë. Po kështu, edhe kalimi nga termi “Gadishulli i Ballkanit” në fjalën “ballkanas”, si dhe deri te derivati i saj “*ballkanizim*”, ishte rezultat i fillimit të rënies së Perandorisë Osmane, i luftërave në rajon dhe i Luftës së Parë Botërore.

Pas Kongresit të Berlinit,⁷ termin “Gadishulli Ballkanik” apo “Ballkan” e kanë zëvendësuar shpikjet që kishin për bazë praninë e

⁴ Pajtim Ribaj, Shpëtim Cami, “Lufta, paqja, siguria (Realitete Ballkanike)” Botim i M&B, Tiranë, 2015, f. 143.

⁵ Luftërat ballkanike ishin të përgjakshme dhe të kushtueshme. Gjatë dhjetë javë luftimesh, gjashtë javë Lufta e Parë Ballkanike dhe katër javë Lufta e Dytë, u vranë rreth 200.000 luftëtarë, pa llogaritur civilët, përveç dhjetëra mijëra viktima të kolerës, tifos e dizenterisë.

⁶ Todorova Maria, “Imagining the Balkans”, New York: Oxford University Press, 1997, p. 11.

⁷ ... Kushtet e vendosura nuk ishin të kënaqshme për asnjërin. Porta, e cila humbi një të tretën e territoreve të saj dhe mbi 20% të popullsisë, u destabilizua në mënyrë të përhershme nga përfundimet e nxjerra. Shih: Ztircher Erik J., “Turkey - A modern history”, London: I. B. Taurus, 1993, f. 85.

osmanlinjve në rajon. Shumë shpejt në përdorimin gazetaresk, termi “Ballkan” mori kuptimin *gjysmë i zhvilluar, gjysmëkolonial, gjysmë-civilizues dhe bota gjysmëorientale*. Ballkani është parë gjithmonë si rajon ndërmjet Krishterimit të Lindjes e të Perëndimit, ndërmjet Pax Christiana dhe Dar al-Aslam. Gjithashtu, është parë edhe si ndarja e *botës së lirë* dhe e *botës prapa perdeve të hekurta*. Perceptimet negative të trashëgimisë osmane në Ballkan nga autorë jomyslimanë ishin faktori kryesor që i ka dhënë shijen e keqe termit “Ballkan”, ndërsa ndërhyrjet e Fuqive të Mëdha nuk lejuan asnjë nga këta popuj të vendosë kufij etnikë apo të marrë në dorë hegjemoninë e rajonit. Për këtë arsye, edhe shek. XX në Ballkan filloi e mbaroi me luftëra etnike, duke e bërë të njohur këtë rajon si “*fuçi baruti*” apo “*shtete të egra*” në Evropë.

Pozicioni gjeografik dhe ekonomik, nga njëra anë, lidhjet dhe afrimet e shumta me popuj e vende të ndryshme të Evropës dhe botës, nga ana tjetër, e bëjnë rajonin e Ballkanit që të mos u shmangët kursesi prirjeve të zhvillimeve politike e gjeopolitike që përfshijnë Evropën dhe mbarë botën. “*Lufta e Ballkanit nuk ka shkatërruar frontet e vjetra në Ballkan*”, - shkruante Leon Trotsky, si një korrespondent lufte për Ballkanin, në mars të 1913, - *ajo ka turbulluar ekuilibrin midis shteteve kapitaliste të Evropës*”.⁸

Roli i gjeopolitikës dhe gjeostrategjisë të Ballkanit Perëndimor në Evropë

Shkrimtari Ismail Kadare në librin “Ballkani i Jugut” thekson se “... është e qartë për gjithkënd se stabiliteti në gadishullin e Ballkanit varet nga dy faktorë kryesorë: së pari, nga vetë popujt e Ballkanit dhe, së dyti, nga Evropa...”.⁹ Pra, me fjalë të tjera mund të themi se kur fati varet nga dy palë, mirëkuptimi ose moskuptimi ndërmjet tyre kthehet në faktor bazë për zgjidhjen ose jo të problemeve. Popujt e Ballkanit kanë nostalgji për Evropën, por njëkohësisht ndjejnë nervozizëm për fajet apo gabimet që s’duan t’i pranojnë, si dhe zemërim për harresën e gjatë të kontinentit të vjetër, e cila për një kohë të gjatë i është shmangur përgjegjësisë së saj në rajon. Nga kjo më sipër arrijmë në përfundimin se Evropa, e lodhur me Ballkanin, ka bërë dhe bën përpjekje për ta integruar e përfshirë atë në organizmat e saj. Po

⁸ Trotsky Leon, “The Balkan Wars, 1912 - 1913”, New York: Monad Press, 1980, f. 314.

⁹ Ismail Kadare, Ballkani i Jugut, Tiranë 2005, f.15.

kështu, edhe popujt e Ballkanit përpiqen të rivendosin marrëdhëniet e vjetra duke i lidhur ato me kulturën, zakonet, doket, marrëdhënie të cilat kanë rrënjë të thella në vendet ku jetojnë, por që janë shkatërruar nga luftërat e vazhdueshme e të pafundme në rajon.

Së pari, Ballkani është vendi i përplasjeve më të mëdha në kohëra, që nga perandoria romake, bizantine, osmane apo monarkia habsburge, si dhe vendi i përzierjes së kulturave dhe popujve të tri kontinenteve. Është për t'u theksuar se në Ballkan nuk ka lënë gjurmë numri i perandorive, por dhuna që ka mbretëruar në rajon pas largimit të tyre. Ekspansioni i Monarkisë Habsburge drejt Juglindjes deri në fillim të shek. XX dhe i Perandorisë Osmane në drejtim të veriut e bëri Ballkanin rajon të përplasjes së tyre, duke rinxitur më tepër ndarjet etnike, gjuhësore e fetare të cilat ekzistonin në Ballkan që nga shek. IV. Një faktor tjetër i nxitjes së nacionalizmit në Ballkan kanë qenë padrejtësitë e bëra nga Fuqitë e Mëdha për zgjidhjen e problemeve gjeopolitike. Ballkanasit i shihnin me dyshim e të padrejta traktatet dhe marrëveshjet (si Traktati i Shën Stefanit, Kongresin e Berlinit, Traktati i Fshehtë i Londrës, Traktatin e Bukureshtit, etj.), të cilat jo vetëm që nuk i shërbenin zgjidhjes së problemeve ballkanike, por e keqësonin më tej situatën.

Së dyti, Ballkani, si një urë lidhëse natyrore që bashkon Evropën me Azinë, ndodhet në “zemrën” gjeopolitike e gjeostrategjike të rajonit, me dy zona kyçe: ishulli i Kretës, që kontrollon gjithë korridoret detare strategjike të Mesdheut Lindor dhe Serbia Jugore dhe Kosova, që konsiderohen nyja tokësore më e rëndësishme e Ballkanit, nëpërmjet së cilës kontrollohen të gjitha akset natyrore strategjike të rajonit.¹⁰

Së treti, çështjet etnike të Ballkanit gjatë gjithë historisë së luftërave të tij përfshi edhe shek. XX, nuk kanë shërbyer kurrë për një “fqinjësi” të mirë mes popujve të rajonit, por vetëm janë përdorur për lëvizje, përfitime e ndryshime politike. Por, në zhvillimet aktuale, Ballkani po tregon se ka ndryshuar aktualitetin e vet gjeopolitik, pasi ka shënuar përparime të dukshme në aspekte të mentalitetit jetik, fqinjësisë, si dhe gatishmërisë për t'u shkuar deri në fund proceseve të nisura për demokratizimin e rajonit dhe integrimin në strukturat euroatlantike. Pas zhvillimeve të fundit në rajon në dekadën e fundit të shek. XX, mund të themi se ndarjet tashmë kanë përfunduar dhe po

¹⁰ Prof. Dr. Pëllumb Danaj, NATO dhe Kosova, Tiranë, 2008, f. 76.

mendohet për të ecur drejt Evropës, pasi Ballkani para së gjithash është pjesë integrale e saj dhe s'ka dyshim që me një Ballkan të destabilizuar nuk do të ketë një Evropë të plotë.¹¹

Nismat kryesore rajonale

Procesi i bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECF) u themelua në vitin 1996, pas iniciativës së Bullgarisë, dhe synonte krijimin e një forumi të ri të bashkëpunimit rajonal pas shfaqjes së shteteve të reja të pavarura në territorin e ish-Jugosllavisë. Ky proces vazhdon të kontribuojë për fuqizimin e bashkëpunimit rajonal, për rritjen e nivelit të sigurisë dhe situatës politike, intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike dhe ndërveprimin në fushën e burimeve njerëzore, demokracisë, drejtësisë, luftës kundër aktiviteteve ilegale e kriminale.

Pakti i stabilitetit për Evropën Juglindore, në shkurt 2008 u zëvendësua nga Këshilli i Kooperimit Rajonal (RCC), për të fituar një pamje apo “ngjyrë” më tepër rajonale. Kjo nismë ishte përgjigjja e bashkësisë ndërkombëtare ndaj krizës në ish-Jugosllavi me një strategji preventive e gjithëpërfshirëse dhe ka qenë shumë shpresëdhënëse e me pritshmëri të larta. Po ashtu, aty u kalua nga koncepti i Ballkanit të koncepti i Evropës Juglindore; që me integrimin e Bullgarisë e Rumanisë u shndërrua në “termin” Ballkan Perëndimor.

Nisma rajonale e sigurisë bashkëpunuese në Ballkanin Perëndimor

Ministeriali i Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM është takimi i ministrave të mbrojtjes të vendeve të Evropës Juglindore) i njohur me emrin procesi i SEDM-it (Southeastern European Defense Ministerial), që është nisma më e madhe rajonale në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes rajonale dhe përfaqëson një histori suksesi të Sigurisë Bashkëpunuese të rajonit tonë.

Fillesa e kësaj nisme daton në vitin 1996, vetëm pak vite pas ndryshimeve demokratike dhe luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, kur në vendet e rajonit kishin filluar ndryshimet demokratike, të demonstruara në përpjekjet e tyre për të ndërtuar një të ardhme larg politikave izoluese dhe përjashtuese. Ky angazhim ishte pa dyshim një detyrë e vështirë, pasi nuk do të ishte e lehtë që vendet të braktisnin dhe/ose të

¹¹ Arben Puto, “Analisti i Ballkanit”, Tiranë 1999, nr. 1, f. 69.

kapërcenin mendësitë dhe trashëgiminë e mosbesimit dhe dyshimit, të ushqyer për dekada dhe shekuj.

Përtej kësaj klime, më 28 mars të vitit 1996, ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë Safet Zhulali inicioi organizimin e një mbledhjeje, në të cilën merrnin pjesë William Perry – Sekretari i Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ministrat e mbrojtjes së Maqedonisë, Bullgarisë, Italisë dhe Turqisë. Vendet nismëtare, të mbështetura fuqimisht nga SHBA, u përqendruan në gjetjen e mënyrave efektive të komunikimit dhe krijimit të një klime bashkëpunimi e mirëkuptimi, në rajonin tonë problematik, të sunduar nga përçarja dhe hakmarrjet, luftërat dhe armiqësitë, një pjesë e të cilave vazhdon të jetë edhe sot e fjetur në kokat e nxehta të nacionalistëve ekstremistë dhe fundamentalistë.

Ky moment dhe kjo filozofi e re bashkëpunimi, përgatiti kushtet për krijimin e procesit të Ministerialit të Mbrojtjes të Evropës Juglindore, i cili vazhdon të jetë i suksesshëm edhe sot, pas 22 vitesh, duke pasur si karakteristikë dinamizmin dhe zgjerimin e kufijve, duke zbatuar politikën e dyerve të hapura, e cila ka dhënë frytet e veta duke e çuar numrin nga 5 në 15 anëtarë dhe një vend vëzhgues.

Procesi i SEDM-it përfaqëson një angazhim politik-ushtarak të vendeve të Evropës Juglindore për forcimin e paqes, sigurisë dhe klimës së mirëbesimit. Objektivat e SEDM janë nxitja e mirëkuptimit të ndërsjellë, besimit dhe bashkëpunimit reciprok ndërmjet vendeve anëtare; promovimi i proceseve të integritit euro-atlantik të vendeve anëtare të SEDM; zgjerimi i procesit SEDM me anëtarë të rinj, bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare (OKB, NATO, BE dhe OSBE) etj.

Procesi i SEDM-it përfshin nismën e Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore, e njohur ndryshe edhe me emrin Brigada e Evropës Juglindore (SEEBRIG), është një angazhim ushtarak i shtatë vendeve të rajonit: Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Italia, Maqedonia, Rumania dhe Turqia. Ndërkohë që fillimisht SHBA dhe Sllovenia dhe më vonë Kroacia, Ukraina, Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia, janë me statusin e vëzhguesit. Brenda kuadrit të kësaj nisme, përveç SEEBRIG, është zhvilluar një numër i konsiderueshëm projektesh të tjerë rajonalë të cilët janë në përputhje me angazhimet e vendeve anëtare dhe sfidat më të rëndësishme, me të cilat përballet i gjithë rajoni ynë.

-Forumi i Shefave të Shtabit të Mbrojtjes (CHOD) të vendeve të Ballkanit. Forumi i Shefave të Mbrojtjes / Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të vendeve të Ballkanit është një nismë rajonale. Qëllimi kryesor i këtij forumi është të rrisë bashkëpunimin ushtarak në të gjitha nivelet dhe të përmirësojë kapacitetet relevante të shteteve të rajonit në mënyrë që të jenë në gjendje dhe të gatshëm për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate kërcënimeve të mundshme asimetrike dhe krizave joushtarake.

- Qendra për Sigurinë Bashkëpunuese (RACVIAC) është krijuar në vitin 2000, si Qendër Rajonale e Ndihmës për Verifikimin dhe Zbatimin e Kontrollit të Armëve me qëllim ofrimin e trajnimit mbi kontrollin e armëve, nxitjen e masave të ndërtimit të sigurisë dhe të besimit, si dhe zgjerimin e bashkëpunimit në Evropën Juglindore. Me qëllim rritjen e stabilitetit rajonal, RACVIAC e ka zgjeruar më tej veprimtarinë e tij, për trajtimin e çështjeve politiko-ushtarake, përfshirë reformën në sektorin e sigurisë dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, me fokus në integrimin euroatlantik. RACVIAC organizon çdo vit rreth 30 aktivitete, ndërsa që nga krijimi, ai ka organizuar rreth 400 aktivitete, me mbi 10.000 pjesëmarrës.

- Karta e Adriatikut. Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia, si vende anëtare të Pfp dhe EAPC, pas Samitit të Pragës në vitin 2002, ku morën ftesën e anëtarësimit shtatë nga dhjetë vendet “aspirante”, vendosën të kenë qasje të njëjtë gjatë rrugës së anëtarësimit të plotë në NATO, sikurse patën vendet baltike, të cilat kishin krijuar Grupin e Vilniusit (Vilnius Group). Në bazë të kësaj eksperience, Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia, krijuan grupin e tyre (A-3), të quajtur Karta e Adriatikut, si pjesë e vizionit për të integruar të gjithë rajonin në NATO, pas përmbushjes së të gjitha kushteve dhe detyrimeve të kërkuara.

Në procesin e pranimit të vendeve A-3 në Aleancë, SHBA, si një partner strategjik, si dhe vende të tjera anëtare të NATO-s, ofruan mbështetje të rëndësishme për të promovuar këtë formë bashkëpunimi midis vendeve të Kartës së Adriatikut.

Karta e Adriatikut, si projekt diplomatik, kishte dy objektiva kryesore – vazhdimësia e politikës së “Dyerve të Hapura të NATO-s” dhe sigurinë bashkëpunuese e mbështetjen reciproke të vendeve kandidate.

Që nga fillimi, Partneriteti i Kartës së Adriatikut parashtrroi zbatimin, i cili përbëhej nga shumë aktivitete trajnuese midis vendeve

të Ballkanit Perëndimor dhe Pfp. Një aspekt i rëndësishëm i bashkëpunimit ishte përgatitja dhe pjesëmarrja në operacionet shumëkombëshe. Së pari, vendet e A-3 kontribuan me ekipet e specializuara mjekësore në operacionet e Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (ISAF) në Afganistan. Shqipëria, Maqedonia dhe Kroacia, nga viti 2005 deri në vitin 2009, kanë dislokuar dy ekipe mjekësore të përbashkëta.¹²

Përveç angazhimit të mëparshëm që rrjedh nga formati A-3, vendet anëtare të A-5 janë përpjekur të mbajnë një nivel të lartë bashkëpunimi. Kështu, sipas propozimit të palës kroate, është në proces përfshirja e vendeve të Kartës së Adriatikut (A-5) me ekipet trajnuese dhe monitoruese në Afganistan.¹³ Para vendosjes së dislokimit, ekipet e kombinuara zhvilluan trajnimin e integritetit në Kroaci. Për shkak se vendet e A-5 kontribuan me kontingjente të vogla, Kroacia si vend udhëheqës (lead nation), siguroi mbështetje logjistike për vendet e tjera A-5. Është shumë e vështirë për vendet e vogla me kontingjente të vogla të dërgojnë në operacione elemente mbështetëse kombëtare për të mbështetur trupat e tyre në zonat e operimit në distanca strategjike, si p.sh. në Afganistan.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i bashkëpunimit rajonal përmes Partneritetit të Kartës së Adriatikut është trajnimi në fusha të ndryshme si operacionet e reagimit ndaj krizave, operacionet e mbështetjes në rast fatkeqësish dhe stërvitjet logjistike.

Së fundmi, teoria e shkollës "konstruktiviste" e sheh dhe mbështet bashkëpunimin rajonal si një mjet të përshtatshëm për socializimin e aktorëve rajonal për paqen dhe prosperitetin. Sipas Levkovska dhe Franklin, "Supozimet konstruktiviste përforcojnë argumentin tonë të interesit të qëndrueshëm për kontributin ndaj paqes dhe stabilitetit që vendet e rajonit kanë zhvilluar në mënyra të ndryshme të ndërveprimit me bashkësinë ndërkombëtare dhe më konkretisht me aleancën".¹⁴ Prandaj, është koha për Ballkanin Perëndimor për të vazhduar në epokën e re të përmbushjes së objektivave të tyre strategjike për të rritur paqen dhe prosperitetin në rajon.

Aktorët kryesor ndërkombëtar në Ballkanin Perëndimor

NATO: Ajo është e pranishme në Ballkan që më 18 shkurt 1952, kur Turqia dhe Greqia iu bashkuan traktatit të Aleancës. Me ngjarjet

¹² Minister of Defence, Republic of Macedonia, "White Paper on Defence."

¹³ Ministry of Defence, Republic of Albania, "U.S - Adriatic Charter (A-5)."

¹⁴ Levkovska and Franklin, p.8.

në ish-Jugosllavi, Ballkani ishte sfida që provoi NATO-n. Ndërhyrja ushtarake e Aleancës në Bosnje e më pas në Kosovë, i dha fund gjakderdhjes në këto dy vende. Kjo vërtetoi se formati i kësaj strukture duhej përshtatur në kushtet e sfidave të reja. Aleanca tashmë është e pranishme në Ballkan me potenciale ushtarake, me nisma të drejtpërdrejta ose indirekte që nxisin bashkëpunimin për paqe, stabilitet dhe siguri në rajon.

SHBA: Prania e SHBA-ve në rajon, kontribuesi kryesor i NATO-s, ka sjellë një element të ri thelbësor tashmë të provuar në zgjidhjen e konflikteve, garantimin e sigurisë dhe paqes, falë kapaciteteve të tyre njerëzore, ekonomike, diplomatike, ushtarake, si dhe politikës së tyre të jashtme unike e pragmatike.

Me rritjen e territorit të NATO-s dhe përfshirjen në Aleancë të vendeve të rajonit, jo vetëm që rritet siguria e përgjithshme, por për vendet e BP kjo do të ishte edhe një “kartë” plus drejt integritimit në BE. Pavarësisht disa aspekteve të diskutueshme, përparësi për NATO-n do të mbetet zhvillimi i partneritetit strategjik me BE dhe përmbushja e angazhimeve për paqe e siguri në Ballkan. Në përpjekje për stabilitet dhe siguri, në funksion të integritimeve rajonale dhe të atyre euroatlantike, vendet e BP kanë përballë tri sfida të vështira: të historisë, tranzicionit dhe integritimit.

Në shkrimin e tij “Time for a new approach? (A ka ardhur koha për një qasje të re)”, Gjeneral major Walter T. Lord, Garda Ushtarake Kombëtare e SHBA, duke analizuar angazhimin e NATO-s në Ballkanin Perëndimor (NATO in the Western Balkans), thekson se që nga viti 1995,¹⁵ NATO, Bashkimi Evropian dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë janë angazhuar në Ballkan – politikisht, diplomatikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht – në shkallë të ndryshme të intensitetit. Sot, pas 23 vjetësh përfshirjeje ndërkombëtare në Ballkan, vendet e pavarura që dikur përbënin ish-Jugosllavinë, po përjetojnë nivele të ndryshme suksesi në përmbushjen e qëllimeve të tyre integruese euroatlantike.

Megjithatë, duke pasur parasysh dinamikën aktuale të sigurisë në Evropë, NATO nuk mund të përballojë për shumë kohë këtë angazhim.¹⁶ Integritimi euroatlantik i bllokuar në Ballkan hap dyert për

¹⁵ NATO in the Western Balkans Time for a new approach? By Maj. Gen. Walter T. Lord, U.S. Army National Guard: Revista e Qendrës Marshall “Condordiam, Volume 8, Issue 1, 2017, f. 40.

¹⁶ Po aty, f. 41.

një mori kërcënimesh që mund të zbulojnë edhe një herë stabilitetin relativ të dy dekadave të kaluara. Më tej, Gjenerali Walter T. Lord shprehet se duke vepruar kështu, padyshim do të hapte derën e paqëndrueshmërisë dhe uljes së nivelit të sigurisë së reduktuar. Ne duhet të rivlerësojmë, riorganizojmë dhe ripërqendrojmë angazhimin dhe përpjekjet tona për të vazhduar të përmirësojmë sigurinë dhe stabilitetin në rajon.¹⁷

Janusz Bugajski, në artikullin e tij të datës 13 mars 2018, "Paqëndrueshmëria e Krahut Qendror të NATO-s"¹⁸, thekson se në një konfiguracion unik territorial, aleanca e NATO-s rrethohet nga një zonë në Evropë që mund të bëhet gjithnjë e më e paqëndrueshme. NATO mbulon katër nga shtetet që dolën nga ish-Jugosllavia – Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Maqedonia dhe Serbia – por që nuk kanë perspektivë të menjëhershme për hyrjen në NATO. Në rastin më të keq, konfliktet brenda dhe midis këtyre shteteve mund të zënë në befasi dhe shkaktojnë probleme për anëtarët e aleancës aty pranë.

Në skenarin më ideal, të gjitha vendet e Ballkanit do të lëviznin drejt anëtarësimit në NATO dhe do të fitonin garanci kombëtare të sigurisë. Por, duke pasur parasysh të gjitha pengesat për pranimin, udhëheqësit e NATO-s nuk mund të supozojnë se konfliktet e armatosura në Evropën Juglindore janë traditë. Përveç zgjerimit të fushëveprimit dhe frekuencës së stërviçjeve të "reagimit të menjëhershëm" në rajon, NATO duhet të përgatisë Plane Kontigjente për një shumëllojshmëri të operacioneve të mundshme luftarake dhe paqeruajtëse brenda krahut të paqëndrueshëm qendror të saj.¹⁹

Bashkimi Evropian (BE): Zhvillimet e fundit të shekullit vërtetuan se rajoni ka nevojë parësore për investime të mëdha ekonomike, të cilat do të ndihmojnë në integrimin e tij në bashkëpunimin evropian. Zhvillimi ekonomik është rruga më e mirë për të parandaluar të gjitha rreziqet e sigurisë që e kanë bazën e tyre te varfëria. BE vazhdon të ketë një interes të madh në stabilitetin e Ballkanit dhe problemet rajonale kanë një ndikim të rëndësishëm në vendet e saj...²⁰
"Në këtë botë mund të ndodhin gjithfarë gjëmash, por është e vështirë"

¹⁷ Po aty, f. 45.

¹⁸ <https://www.cepa.org/NATOs-unstable-central-flank>, hyrë më 15 Mars 2018.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Efekti mund të jetë negativ nëse rajoni përkeqësohet nga situata e sigurisë në drejtim të kaosit dhe konfliktit. Disa ekspertë evropianë kritikojnë politikën aktuale të BE-së, për mungesë vizioni në politikën e saj ndaj Ballkanit.

*që një popull ballkanas të thuhet nga një tjetër popull ballkanas. Kur popujt e Gadishullit të ndërjegjësohen për këtë të vërtetë, kur ata të kuptojnë se i vetmi shans për ta është e kundërta e konfliktit, ata do të vihen vërtetë në rrugën e shpresës”.*²¹

Ballkani tani është plotësisht i orientuar drejt BE-së, drejt kësaj organizate ku ata shohin perspektivën e tyre ekonomike. BE është zotuar për zgjerimin e saj në drejtim të Ballkanit Perëndimor, pra të përfshirjes së atyre shteteve që ende nuk janë të anëtarësuara. Ajo që është pozitive në një analizë të sigurisë në Ballkan, është fakti se të gjitha shtetet, pa përjashtim, kanë shprehur interesimin e tyre për anëtarësimin në NATO. Klima e volitshme ekzistuese e sigurisë e krijuar në këtë rajon është meritë e shtrirjes së Aleancës Veri-Atlantike si dhe anëtarësimit të një numri sa më të madh të shteteve të Ballkanit.

Gjeopolitika e vendeve të rajonit nuk ndikohet vetëm nga zhvillimet ndërshtetërore të vendeve të saj, por dhe nga ndikimi në mënyrë të drejtpërdrejtë i Fuqive të Mëdha nëpërmjet institucioneve ndërkombëtare politike, ekonomike dhe ushtarake. Ky problem përcillet nga historia²² dhe ende vijon të jetë i pranishëm.

Rusia: Sipas Robert BARIĆ²³, konfrontimet ruse me Perëndimin mbi fatin e Ukrainës kanë ngritur pyetje në lidhje me synimet e Moskës në Ballkanin Perëndimor. Ky rajon ka qenë një zonë me rëndësi strategjike për Rusinë për shekuj. Qëllimi rus në Ballkan, pas vitit 1991 ka qenë për të rinovuar dhe rritur praninë e tij, duke përdorur energjinë dhe mbështetjen financiare si mjet konkurrues me Bashkimin Evropian, për ndikim në rajon, ku qëllimi kryesor është pengimi i zgjerimit të NATO-s dhe BE-së në rajon. Moska ka aplikuar dhe po aplikon mënyra nga më të ndryshmet për të ndikuar në vendet që janë anëtare të NATO-s dhe BE-së ose kandidatët për anëtarësim.

²¹ Kadare, Ismail, “Ballkani i Jugut”, Tiranë: Onufri, 2005, f. 15.

²² “Ne jemi pjesë e situatës së përgjithshme të Evropës”, sikurse shkruan shkrimtari sloveno-amerikan në Sarajevo në 1933, “ne mik kemi mundësinë për të arritur qëllimin final. Ne jemi pjesë e politikës ndërkombëtare të Fuqive të Mëdha”. Shih: Poulton Hugh, “The Balkans: Minorities and slates in conflict”, Iondon: Minority Rights Publications, 1991.

²³ Robert BARIĆ, Lektor në Kolegjin e Luftës së Forcave të Armatosura të Kroacisë, referat në Konferencën “Croatia in Contemporary Security Environment - Threats, Challenges and Responses”, f. 17, organizuar nga Instituti për Zhvillim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Zagreb, 2015.

Janusz Bugajski, në artikullin e tij të datës 08 shkurt 2018 “Pse Moska ka frikë nga NATO”,²⁴ thekson se Moska ka fabrikuar një tymnajë të madhe disinformimi rreth NATO-s, në mënyrë që të maskojë politikat e saj ekspansioniste në Evropën Lindore. Megjithatë, duke qëndruar prapa kësaj propagande ofensive, a ka një frikë të vërtetë në Kremlin se Aleanca e Atlantikut të Veriut do të pengojë ambiciet e Kremlinit dhe do të dobësojë regjimin e Presidentit rus Vladimir Putin.

Miti i NATO-s në Rusi mund të debatohet, duke shqyrtuar provat. Sipas mashtrimeve të Moskës, Rusia u përpoq të bashkohej me institucionet perëndimore gjatë viteve 1990, por u kundërshtua dhe u largua. Në realitet, Federata Ruse nuk ka dështuar të përmbushë standardet themelore për anëtarësimin në BE apo NATO, qoftë në sundimin e ligjit, në qeverisjen demokratike apo në reformat ushtarake, dhe aspiratat e saj agresive ndaj shteteve fqinje janë në kundërshtim me parimet bazë të të dy organizatave shumëkombëshe.

Siç përshkruhet më sipër, Ballkani Perëndimor (BP) mbetet një rajon i rëndësishëm gjeopolitik, gjeoekonomik e gjeostrategjik, për të cilin SHBA-të, BE-ja dhe Rusia kanë interesa të mëdha. Ndërkohë që vendet e BP janë përfshirë në një rrugë të pakthyeshme integrimi në strukturat euroatlantike, edhe pse proceset e transformimit rajonal janë ende larg përfundimit.

Dy shtyllat kryesore të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor janë, nga njëra anë, institucionet euroatlantike dhe, nga ana tjetër, bashkëpunimi rajonal. Nuk do të ishte ekzagjerim të thuhet se në saje të këtyre faktorëve kryesorë, Ballkani Perëndimor aktualisht është më i qëndrueshëm politikisht dhe në aspektin e sigurisë sesa në çdo moment në 20 vitet e fundit. Gjatë 10 viteve të fundit në veçanti rajoni ka përjetuar dy sfida të mëdha dhe në të dyja rastet ka treguar një qëndrueshmëri të jashtëzakonshme.

E para janë ngjarjet në dhe rreth Kosovës në vitin 2008 kur, përnjëherë, një shkëputje e njëanshme nuk çoi në reagime ushtarake dhe të gjithë fqinjët rajonal pranuan qasje të ndryshme, por të pjekura. Demonstrimi më i mirë i nivelit të ri të stabilitetit të rajonit ishte fakti se një institucion rajonal gjithëpërfshirës, Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit (RCC), i cili zëvendësoi Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore, u mblodh për takimin konstitucional vetëm disa ditë pas shpalljes së pavarësisë nga ana e Kosovës.

²⁴ <https://www.cepa.org/NATOs-unstable-central-flank>, hyrë më 15 Mars 2018.

E dyta është kriza ekonomike, e cila edhe kur goditi rajonin më të vështirë, nuk shkaktoi destabilizim politik në asnjë prej vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe as nuk ndikoi negativisht në marrëdhëniet mes tyre. Nuk ka pasur dëshmi se kriza ekonomike ka një efekt negativ në marrëdhëniet ndëretnike, të cilat kanë qenë gjithmonë midis faktorëve kryesor destabilizues në Ballkanin Perëndimor. Në një farë mase, ky rajon sfidon sot disa prirjet shqetësuese në Evropën më të gjerë, duke përfshirë një rritje të ndjenjës nacionaliste dhe rritjen e popullaritetit të partive politike të ekstremit të djathtë.

Kriza e fundit e refugjatëve, e cila që nga viti 2015 ka prekur një numër vendesh përgjatë të ashtuquajturës Rrugë e Ballkanit Perëndimor, është bërë një barrë serioze për ta. Dhe, megjithatë, pavarësisht tensioneve të rastit në marrëdhëniet dypalëshe, këto vende në përgjithësi i janë përgjigjur sfidës së re me përgjegjësi. Situata mund të kishte qenë shumë e ndryshme në qoftë se bashkëpunimi rajonal ekzistues nuk do të funksiononte.

Conclusions

The region is involved in various forms of co-operation with NATO, where some of the NATO member countries and the rest are members of the Partnership for Peace. The Alliance remains an important source of regional stability. The most important is the engagement and scrutiny system that derives from the European Union Stabilization and Association Process, which effectively plays a key stabilizing role today. Croatia's accession to the European Union in July 2013 was rightly welcomed by the neighbours of the Western Balkans, not only as a confirmation of the European prospects for the Western Balkans, but also as a direct contribution to strengthening the stability of the region and increasing attractiveness an investment destination.

Of course, the EU is currently making efforts today, as it did at the start of the Stabilization and Association process and adopting the Thessaloniki agenda, to find the right balance between the need to respect the stringent conditions and the desire to support stability in the Western Balkans while maintaining momentum in the process of approximation with the EU. What is important to note is that – regardless of all concerns regarding the situation in the Eurozone or Brex - there is a clear understanding that it is in its strategic interest of the European Union to continue with the integration of the Western Bal-

kans into the Union European; a realization that supports all relevant EU documents of recent years, including the EU Enlargement Strategy ("Strategy 2025") adopted by the EC on 6 February 2018. Integration into the European Union is not a remedy for all BP problems, but it is the most efficient tool that Brussels should keep these countries on the right track and to support regional stability, and what is more important should maintain the enthusiasm and confidence of BP countries for EU membership.

The approach of regional leaders has evolved in a positive way, expressed in the commitment to regional co-operation and stability. Another important achievement is a number of collaborative security agreements which, amongst other things, require that all members should be ready for diplomatic, economic and, if necessary, military action, when in territories or spaces of them, threatens development and stability.

The focus of regional cooperation will be: Supporting the integration of regional countries into NATO; creation and development of a regional security network, in order to strengthen the information exchange capacities among the countries of the region on security issues and confrontation with civil emergencies; engagement and fulfilment of obligations deriving from regional initiatives (US-Adriatic Charter (A-5), SEDM, RACVIAC, SEESAC); the adoption of legal and sub legal acts and other commitments stemming from the Balkan Medical Task Force (Balkan Medical Task Force).

The Western Balkans has already entered a new path, in that of change. This new spirit has a broad base where it is based, since the Balkans have for the first time seen a common view in a few years of devastating wars, big and small problems, all kinds of confusions. All countries in the region have a democratic political system and basically have a free-market economy; all countries of the region, without exception, aspire to EU membership and are actively aspiring to NATO membership.

Bibliografia:

Ismail Kadare "Ballkani i Jugut", Tiranë: Onufri, 2005

Arben Puto, "Ballkani koha për të ndryshuar", botuar në "Analisti i Ballkanit", Nr. 1, Tiranë: janar-mars 1996,

Maria Todorova "Imagining the Balkans", Neë York: Oxford University Press, 199

Pajtim Ribaj dhe Shpëtim Cami “Lufta, paqja, siguria (Realitete Ballkanike)”, Botim i M&B, Tiranë, 2015.

Leon Trotsky “The Balkan Wars, 1912 - 1913”, New York: Monad Press, 1980

Prof. Dr. Pëllumb Dana “NATO dhe Kosova” Tiranë, 2008.

Major General Walter T. Lord, U.S. Army National Guard: Revista e Qendrës Marshall “Condordiam, Volume 8, Issue 1, 2017.

Prof. Dr. Pajtim Ribaj, “Sfidat e rajonit të Ballkanit”, Tiranë, 2005.

Oleg Levitin and Peter Sanfey “Regional cooperation in the Western Balkans”, file:///C:/Users/PC/Downloads/western-balkans-summit-paper.pdf, hyrë më 10 Maj 2018.

Arben Puto, “Analisti i Ballkanit”, nr.1, Tiranë 1999.

Robert BARIÇ, Lektor në Kolegjin e Luftës së Forcave të Armatosura të Kroacisë, referat në Konferencën “Croatia in Contemporary Security Environment - Threats, Challenges and Responses”, organizuar nga Instituti për Zhvillim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Zagreb, 2015.

Poulton Hugh, “The Balkans: Minorities and states in conflict”, London: Minority Rights Publications, 1991.

Zircher Erik J., “Turkey - A modern history”, London: I. B. Taurus, 1993.

<http://www.esiweb.org/GeopoliticsattheEndoftheTwentiethCenturyTheChangingWorldPoliticalMap>.

Ministry of Defence, Republic of Macedonia, “White Paper on Defence.”

Ministry of Defence, Republic of Albania, “U.S - Adriatic Charter (A-5).”

<https://www.cepa.org/NATOs-unstable-central-flank>, hyrë më 15 Mars 2018.

<https://www.cepa.org/NATOs-unstable-central-flank>, hyrë më 15 Mars 2018.